



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA LEZHË  
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 16490/ Prot.

Lezhë, më 22. 10. 2024

**PROCESVERBAL**

I mbajtur sot, në datën 22.10.2024, në orën 11:00, në sallën në katin e tretë në Pallatin e Kulturës Lezhë, mbi dëgjuesën publike në lidhje me miratimin rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së titujve të nderit si dhe vendosjes së emërtesave të rrugëve, shesheve, territoreve, institucioneve dhe objekteve në juridiksionin e Bashkisë Lezhë.

Takimi u hap nga Kryetari i Këshillit të Bashkisë Lezhë z. Ndue Luli, i cili bëri një prezantim të nevojës së hartimit të kësaj rregulloreje dhe më pas i dha fjalën sekretares për të lexuar në vija të përgjithshme dokumentin e propozuar.

Në vijim kryetari u dha fjalën të pranishmëve për diskutime lidhur me propozimin.

Ernest Rakaj- Administrator Nj.A. Shënkoll: Mendoj që duhet të bëhen takime në çdo njësi, ku të jenë të pranishëm dhe anëtarë të këshillit bashkiak, ku të vlerësohen figurat sipas meritave dhe mos të abuzohet me emrat që propozohen.

Artan Ndreu- Anëtar KB Lezhë: Po ta shohësh kështu, duket si vendim i thjeshtë, por ka shumë rëndësi. Është bërë një paçavure përpara. Të bëhet shumë kujdes edhe në këshill.

Marte Simoni- Organizata e Veteranëve: Unë kam një pyetje. Çfarë do bëhet me këto emërtime që janë aktualisht?

Fatjon Zefi- Zv/kryetar i Bashkisë: Do shikohen dhe do rregullohen në bazë të kësaj rregulloreje.

Marte Simoni- Organizata e Veteranëve: Të shikohet kontributi që kanë dhënë për Lezhën, të kenë lënë një gjurmë.

Frrok Simonaj- Kryetar fshati Lalm i Ri: Ka rrugë me mangësi sepse nuk kanë emra të vendosur. Të shikohen këto raste.

Ndue Luli- kryetar KB Lezhë: E drejtë. Prandaj po e bëjmë këtë rregullore, që të rregullohet kjo gjë.

Artan Ndreu- Anëtar KB Lezhë: Të bëhet një filtër dhe për propozimet.

Ndue Luli- kryetar KB Lezhë: Këtu janë prezent dhe administratorët e njësive. Do shikohen hapat që do ndiqen dhe kjo do çojë në dakordësi nga të gjitha palët.

A ka mendim tjetër? Nuk Ka.

Atëherë ju falenderoj për pjesëmarrjen dhe mendimet.

**SEKRETARI**

**FLORIDA ÇUNAJ**



**KRYETARI**

**NDUE LULI**

